

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË DURRES
NR. 272 Rep.
NR. 233 Kol.

**KONTRATË KONCESIONI E FORMËS "BOT"
(NDËRTIM – OPERIM - TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHTA",
"KLOSI", "DOMI", "LUCI", "SHOSHAJ", "ZENISHTI" DHE "BURRELI"**

NE DURRES, më datë 21, muaji Shkurt, viti 2012 (dy mijë e dymbëdhjete), para meje noter _____, anëtar i dhomës së Noterisë DURRES, me adresë _____, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet "AUTORITETI KONTRAKTUES", përcaktuar si i tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1356, datë 10.10.2008, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncension të hidrocentralit "Stavec I", dhe miratimin e bonusit në procedurën perzgjedhese konkurruese që i jepet shoqërisë", përfaqësuar nga Tiullari, z. _____, i datëlindjes _____ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova nga _____.

DHE

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energji Project" Sh.p.k. dhe "ATLANTIK" Sh.a., që në vijim do të quhet "KONCESIONARI", i formuar sipas marrëveshjes nr.234/2 Kol. nr.416 Rep. datë 19/02/2009 me këto të dhena:

Shoqëria "EHW Sh.p.k.", e cila figuron e regjistruar si person juridik me Vendim Gjykatë Nr. 21525/5, dt. 13.11.2006 me NIPT J61804031;

~~Shoqëria "Energy Project Sh.p.k." e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT K81421038P dhe datë 21.02.2008 regjistrimi;~~

Shoqëria "ATLANTIK Sh.a." e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT K11807008V dhe datë 07.06.2001 regjistrimi.

Shoqëria "Riviera Sh.p.k.", e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKR me NIPT J66903244D, datë regjistrimi 03.07.1995, është përcaktuar si shoqëri kryesuese dhe përfaqësohet nga Drejtori Ekzekutiv _____, i biri _____ i datëlindjes _____.

Faqe 1 nga 24

KONTRATË KONCESIONI E FORMËS "BOT" PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHTA", "KLOSI",
"DOMI", "LUCI", "SHOSHAJ", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a."

, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta

Hyrje

Duke patur parasysh si:

Qeveria e Shqipërisë

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike përmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;

2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

3. Vlerëson formën "BOT" të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;

4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit të sipërpërmendur si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Dom", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli", në rrjedhen e lumit Mat, rrethi Matit, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare për të realizuar projektin e miratuar sipas objektivit të kësaj marrëveshje;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për koncesionet" i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1356, datë 10.10.2008, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie me koncesion të hidrocentralit "Stavec 1".

Faqe 2 nga 24

KONTRATI KONCESIONI E FORMES "BOT" PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHTA", "KLOSI", "DOM", "LUCI", "SHOSHAJ", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bushkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.u"

dhe miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkruuese qe i jepet shoqerise", dhe bien dakord per sa me poshte:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni I Përkufizime dhe interpretime

1. Kudo që të ketë Kontratë përdoren termat e mëposhtëme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon:
- 1.1. **Kontrata e koncesionit** : Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
 - 1.2. **Ligji "Për Koncesionet"**: Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 "Per koncesionet", i ndryshuar.
 - 1.3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 - 1.4. **Koncesionari**: Bashkimi i përkohshëm i shoqërive: "Riviera sh.p.k" "EHW sh.p.k", "Energy Project sh.p.k" dhe "ATLANTIK sh.a.", ku Shoqëria "Riviera Sh.p.k sh.p.k." është përcaktuar si shoqëri kryesuese, me seli ne TIRANE, adresa: _____
 - 1.5. **Hidrocentralet**: Hidrocentralet "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli", me vendndodhje ne lumin Mat, rrethi Matit me fuqi te instaluar 31 700 kW dhe prodhim të energjisë elektrike 133.259.000 kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, bazenën e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbinën, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluar në të.
 - 1.6. **Objekti**: Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentralit/ëve dhe transferimi i tij/tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
 - 1.7. **Investimi**: Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe pajisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentralit/ëve, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
 - 1.8. **Punimet**: Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli", në përputhje me projektin e zbatimit.
 - 1.9. **Fillimi i punimeve**: Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8.2 të kësaj kontrate.
 - 1.10. **Vënia në punë e hidrocentralit/ëve**: Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
 - 1.11. **Kontratat**: Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt operimin e hidrocentralitëve dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
 - 1.12. **Leje dhe Liçenca**: Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Faqe 3 nga 24

KONTRATI KONCESION F I FORMES "BOTI" PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHTA", "KLOSI", "DOMI", "LUCI", "SHOSHAJ", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a"

- 1.13. **Operimi:** Të gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
- 1.14. **Tarifa koncesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
- 1.15. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përfshihet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
- 1.16. **Data Efektive:** Nënkupton datën në të cilën kjo Kontratë do të hyjë në fuqi sipas miratimit me Vendimin të Këshillit të Ministrave.
- 1.17. **Suhjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislationit shqiptar.
- 1.18. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas Nenit 14.
- 1.19. **Ligj:** Nënkupton çdo ligj organik, dekret, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdhër, licensë, feje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qëndror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 1.20. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, i ndryshuar.
- 1.21. **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
- 1.22. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 1.23. **Paleta Financiare:** Nënkupton institucionet financiare të licencuara si të tilla, që do të ndihmojnë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.
- 1.24. **Projekti Filleshtar:** do të thotë projekti origjinal i propozuar Autoritetit Kontraktor nga Koncesionari dhe në bazë të të cilit Koncesionari u shpall fitues i tenderit.
- 1.25. **"E Drejta për Kalim"** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
- 1.26. **"Shesh"** do të hotë sheshi që gjendet rreth lumit Mat dhe Xiberr, në përputhje me termat e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarde, sipas përcaktimeve në Projektin final të Zbatimit, sic është miratuar nga të dy Palët.

1.27. "Gëzim i qetë" do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë Objektet Ekzistuese) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Afatit, në përputhje me këtë Marrëveshje, pa ndërhyrje të parregullt nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror apo ndonjë pale të tretë.

2. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:

2.1. Një referim përfshin shumësin dhe anasjelltas:

2.2. Referimi të njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjansë:

2.3. Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", "të njëra" apo të njëjshme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura:

2.4. Fjalët që përdoren për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë të njëjta për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate:

2.5. Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.

2.6. Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:

2.6.1. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurtuese;

2.6.2. Oferta e Koncesionarit;

2.6.3. Dispozitat e kësaj kontrate;

2.6.4. Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;

2.6.5. Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.

Neni 2

Objekti i Koncesionit

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për koncesionet", i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentraleve dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentralit/eve

3.1. Hidrocentralet "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domit", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli" do të ndërtohen në lumin e Matit, rrethi i Matit me këto karakteristika:

Faqe 5 nga 24

KONTRATI KONCESION, I FORMES "BOT" PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHTA", "KLOSI",
"DOMIT", "LUCI", "SHOSHAJ", "ZENISHTI" "BURRELI"
Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a"

-	Hidrocentrali "Gjoni"	
-	Kuotat e veprave	
o	Kuota e veprës së marrjes, lumi Mat	590 m
o	Kuota e godinës së centralit	480 m
-	Fuqia e instaluar	4.660 kW
-	Prodhimin vjetor i energjisë elektrike	22.240.000 kWh
-	Hidrocentrali "Mishta"	
-	Kuotat e veprave	
o	Kuota e veprës së marrjes, lumi Mat	479 m
o	Kuota e godinës së centralit	437 m
-	Fuqia e instaluar	2460 kW
-	Prodhimin vjetor i energjisë elektrike	11.727.000 kWh
-	Hidrocentrali "Klosi"	
-	Kuotat e veprave	
-	Kuota e veprës së marrjes, lumi Mat	350 m
-	Kuota e godinës së centralit, perroi Zulli i Dishtit	350 m
-	Fuqia e instaluar	11.100 kW
-	Prodhimin vjetor i energjisë elektrike	52.585.000 kWh
-	Hidrocentrali "Domi"	
-	Kuotat e veprave	
-	Kuota e veprës së marrjes, lumi Mat	197 m
-	Kuota e godinës së centralit	185 m
-	Fuqia e instaluar	2240 kW
-	Prodhimin vjetor i energjisë elektrike	7.550.000 kWh
-	Hidrocentrali "Luci"	
-	Kuotat e veprave	
-	Kuota e veprës së marrjes, lumi Mat	197 m
-	Kuota e godinës së centralit	172 m
-	Fuqia e instaluar	2240 kW
-	Prodhimin vjetor i energjisë elektrike	7.830.000 kWh
-	Hidrocentrali "Shoshaj"	
-	Kuotat e veprave	
-	Kuota e veprës së marrjes, lumi Mat	172 m
-	Kuota e godinës së centralit	153 m
-	Fuqia e instaluar	3000 kW
-	Prodhimin vjetor i energjisë elektrike	10.180.000 kWh

Faqe 6 nga 24

- Hidrocentrali "Zenishti"
- Kuola e veprave 153 m
- Kuola e veprës së marrjes, lumi Mat 140 m
- Kuola e godinës së centralit 3000 kW
- Fuqia e Instaluar 10.477.000 kWh
- Prodhim i vjetor i energjisë elektrike

- Hidrocentrali "Burreli"
- Kuola e veprave 140 m
- Kuola e veprës së marrjes, lumi Mat 128 m
- Kuola e godinës së centralit 3000 kW
- Fuqia e Instaluar 10.670.000 kWh
- Prodhim i vjetor i energjisë elektrike

3.2 Koncesionari, mund të ndryshojë karakteristikat e përcaktuara në Projektin Fillestar (duke respektuar termat e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Procedurës Konkurruese për këto hidrocentrale) gjatë hartimit të projektit të zbatimit ("Projekti i Zbatimit"), në mënyrë që të mund të optimizojë skemën e shfrytëzimit energjistik të veprës me kusht që Autoriteti i Kontraktor të japë aprovimin me shkrim për këtë ndryshim.

Neni 4 Periudha e Koncesionit

4.1. Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vitesh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive ("Periudha Efektive"). Megjithatë, në rastin e Zgjidhjes përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes.

4.2. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:

4.2.1. Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore, Periudha e Koncesionit do të zgjatet në përputhje me kohën e dukur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshatshëm në përputhje me analizat financiare të "Vlerës për Para", "IRR" apo çdo lloj analize tjetër të përshatshme për vlerësime të tilla. Në çdo rast shtyrja nuk duhet të jetë më e shkurter se periudha e vonesës e shkaktuar nga sa me sipër.

Faqe 7 nga 24

KONTRATI KONCESIONAR I FORMES "BOT" PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHITA", "KJOSI", "DOMI", "LUCT", "SHOSHAJ", "ZENISHTI", "BURRELI" BASHKIMI I PERKOHSEM I SHOQERIVE "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.u"

KREU II
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5
Të drejtat koncesionare - Sheshi

5.1. Dhënia e Drejtave Koncesionare

Që në Dajçin e Kryes në fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë Periudhën e Koncesionit (bashkërisht referuar si "Të Drejtat e Koncesionarit"):

- i. të projektojë, planifikojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi, të operojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralet;
- ii. të lidhë Hidrocentralet në pikën e lidhjes të përcaktuar nga entiteti/personi juridik shtetëror/privat kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- iii. në varësi të Nenit 5.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;
- iv. me mbarrimin e Afatit t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentralit dhe të Objekteve Ekzistuese ose të shtuara, nese ka: si dhe, në çdo rast, t'i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjidhmërisht të lidhura me këto aktivitete
- v. Koncesionari do të ketë të drejtën ekskluzive ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në certifikatat CER.

5.2. Dhënia e Sheshit

5.2.1 Autoriteti Kontraktues duhet t'i sigurojë Koncesionarit Gëzimin e Qetë të Sheshit, i cili është pronë shtetërore, duke përfshirë por pa u kufizuar në mbajtjen e Koncesionarit të padëmtuar dhe të dëmshpërblyer kundrejt pretendimeve nga palët e treta në lidhje me pronën shtetërore.

5.2.2 Në përputhje me ligjin dhe Projektin e Zbatimit, Koncesionari mund të nisë procesin e shpronësimit në kohën e duhur në lidhje me ndonjë nga ngastrat e Sheshit, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme nga ana e Koncesionarit. Për shmangien e dyshimit, çdo ngaster toke e shpronësuar, në përputhje me sa më sipër do të konsiderohet të jetë e inkorporuar me Sheshin (duke përfshirë edhe Gëzimin e Lirë). Në rast se Autoriteti Kontraktues, pas dorëzimit të kërkesës për shpronësim nga koncesionari, nuk arrin të kryejë procedurat përkatëse në përputhje me ligjin, Koncesionari ka të drejtë të dergojë një Njoftim për Ndërprerje për Autoritetin Kontraktues.

5.2.3 Pavarësisht nga sa parashikohet në Nenin 5.1 më sipër, Sheshi, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Qetë do të konsiderohen se i jepen koncesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të certifikatave siguroese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues), se Koncesionari është pajisur me policat e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë qëllim në përputhje me nenin 15 të kësaj kontrate.

Faqe 8 nga 24

5.2.4 Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujën e lumit Mat, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim, as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim përkundrejt Koncesionarit, në lidhje me gjendjen e Sheshit.



6.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate.

6.2. Mbikqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme me afate tre mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 7 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

7.1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar apo ndryshimeve në legjislacionin shqiptar në fuqi.

7.2. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj. vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.

Faqe 9 nga 24

- 7.3. Të miratojë Projektin e Zbatimit të hidrocentraleve, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës. Në rast të ndryshimit të projektit nga propozimi fillestar, Koncesionari duhet të marrë paraprakisht miratimin e Autoritetit Kontraktues për ndryshimet që do të behen dhe me pas, Autoriteti Kontraktues do të miratojë Projektin e zbatimit me ndryshimet e miratuara, në përputhje me nenin 3.2 të kësaj kontrate.
- 7.4. Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
- 7.5. Të garantojë, sipas legjislacionin në fuqi, Koncesionarin, nëse kerkohet nga ky i fundit, të lidhë një kontratë me subjektin e furnizimit të energjisë elektrike për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga keto hidrocentrale, për një periudhë të paktën 15 vjetare në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe/ose aktet nenligjore e normative të nxjerra në zbatim të tij dhe sipas tarifave të përcaktuara nga ERE.
- 7.6. Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen dhe vënien në punë të projektit të Koncesionarit.
- 7.7. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së kushteve të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

KREU III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Koncesionarit

- 8.1. Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

a. Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit, shoqërinë koncesionare, që do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

b. Me krijimin e shoqërisë së re koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kontratë transferohen automatikisht nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Koncesionari dhe shoqëria e re e krijuar do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë, për periudhën nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate deri në testimin e veprës sipas nenit 11 të kësaj kontrate. Pas kësaj periudhe, Koncesionari do të çlirohet nga çdo përgjegjësi në lidhje me HEC-et.

Faqe 10 nga 24

c. Një kopje e këtij të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do të dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonese për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë kërkohet që në përmbajtjen e Statutit të përfshihen të paktën:

i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri aksionere", duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

ii. Objekti i shoqërisë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli", tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kundërshtim të kësaj Kontrate);

iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me Periudhën e Koncesionit sipas kësaj Kontrate Koncesioni;

iv. Themelues i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetëm nga Koncesionari.

- 8.2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 8 muajve nga dita e hyrjes, në fuqi të kësaj kontrate.
- 8.3. Të marrë të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në Datën Efektive.
- 8.4. Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit I bashkëlidhur kontratës;
- 8.5. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- 8.6. Të zbatojë Projektin final të Zbatimit për ndërtimin e hidrocentraliteve "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli", me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 31.700 kw;
- 8.7. Të administrojë projektin për Periudhën e Koncesionit;
- 8.8. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambjentin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes).
- 8.9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventalisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
- 8.10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- 8.11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

faqe 11 nga 24

- 8.12. Koncesionari kur vepron ne hidrocentrale duhet të respektojë kufijtë e përdorimit të ujit, sic përcaktohet në Lejen për përdorimin e burimeve të ujit, në pajtim me kushtet e projektit të paraqitur nga Koncesionari, në mënyrë që të ruaje burimet e ujit, për furnizimin lokal me ujë;
- 8.13. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit ekologjik në shtatin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi në Datalën Efektive;
- 8.14. Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm në periudhën e përdorimit të tij për vadiqe për kanalin Beishi, Klos, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi për rezervat ujore;
- 8.15. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- 8.16. Koncesionari ka të drejtë, kundrejt zgjedhjes së tij për shitjen e energjisë që i përket pjesës së tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet, po ashtu me qëllim marrjen e certifikatave të gjelbërta apo ndonjë nxitje tjetër ekuivalente, që ka të bëjë me prodhimet e energjive të rinovueshme, duke patur parasysh parashikimin e pikës 8 të këtij neni.
- 8.17. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Koncesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolën e mbikqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kesaj veprimtarie.
- 8.18. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

Neni 9 Vlerësimi i Investimeve

- 9.1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 4.069.596.314 (katër miliard gjashtenentemilion pesëqindentetdhjetegjashtemije e treqindkatërmbëdhjete) lekë, sipas Aneksit nr. I bashkelidhur, nga te cilat 2.599.114.700 (dy miliard e pesëqindentetdhjetenentemilion e njëqindkatërmbëdhjetemije e shtatëqind) lekë do të investohen në makineri e pajisje
- 9.2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:
- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit i cili mund të përmiresohet por duke patur parasysh kufizimet e nenit 3, pika 3.2, të kesaj kontrate,
 - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;

Faqe 12 nga 24

Neni 10
Programi punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

- 1 Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 90 ditësh nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit. Aplikimi për pajisjen me leje ndërtimi, do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e ngratimit të projektzbatimit përfundimtar nga Autoriteti Kontraktues.
- 2 Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin brenda 15 (pesëmbëdhjete) muajve nga marrja e lejeve. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 18 (tetëmbëdhjete) muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontrates së Koncesionit. Afati i ndërtimit është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, hashkëlidhur.
- 3 Këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proceduriale për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë e barabartë me kohën e vonesave të krijuara nga cdo Autoritet Kompetent Shqiptar.

Neni 11
Testimi i veprës

- 11.1. Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i veprës, për të siguruar funksionimin e hidrocentraleve. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 60 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 11.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

Neni 12
Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

12.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

- 12.1.1. Kur Koncesionari nuk fillon punën për 8 muaj (për shkak të tij) nga data e marrjes së lejes së ndërtimit sipas nenit 10.1. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
- 12.1.2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, përveç rastit të forcës madhore (neni 20);

Faqe 13 nga 24

12.1.3. Kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat e Shoqërisë së re koncesionare, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

12.1.4. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme, për arsye që nuk kanë lidhje me:

a. Forcen Madhore.

b. cdo ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Koncesionarit ose Shoqërisë koncesionare përtej atyre që përfshihen në Forcën Madhore:

mospërbushjen nga ana e Autoritetit Kontraktues të detyrimeve të përcaktuara në kontratë.

Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14 si dhe hidrocentralin siç është në momentin e braktisjes, pa patur asnjë detyrim të çdo lloji karshi koncesionarit apo shoqërisë koncesionare.

12.1.5. Kur shoqëria e re koncesionare është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi ne pafaltesisht paguese ose situata të tjera të ngjashme, për faj të koncesionarit, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.

12.1.6. Kur Koncesionari nuk zbaton në mënyrë të përsëritur një/disa nga detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë.

12.1.7. Kur nuk siguron financimin e projektit brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentraleve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

12.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari:

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkelje serioze të detyrimeve të tij kontraktore që përfshijn rastet si më poshtë dhe nuk e korrigjon këtë shkelje, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12.4 të këtij neni:

- i. dështimin për të garantuar Gëzimin e Qetë të Sheshit sipas nenit 5.2 dhe nuk rregullon këtë shkelje brenda afatit të parashikuar në pikën 12.4 të këtij neni.
- ii. Pavarësisht plotësimit të kriterëve për lejet dhe licensave nga Koncesionari dhe ndërhyrjet e Autoritetit Kontraktues, Koncesionarit nuk i janë dhënë lejet e nevojshme për fillimin e punës dhe/ose operimin e projektit.

Faqe 14 nga 24

12.3. Zgjidhja e kontratës nga secila palë:

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

12.3.1. Megjithatë plotësimin e kriterëve nga ana e Koncesionarit për aplikim për leje, liçenca në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues. Koncesionari nuk është pajisur me to. për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projekti t.

12.3.2. Në rastet e parashikuara nga neni 20 pika 20.3 e kësaj kontrate

12.4. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër në mënyrë që të japin mundësinë për të korrigjuar ose për të marrë veprime për të rregulluar shkeljet. Njoftimi duhet të përmbajë:

Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;

Data e përfundimit të kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda 60 ditëve nga data e njoftimit;

Motivitetin e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;

iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

12.5. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston, me kusht që të ketë paguar kompesimin e rene dakort me negociim midis dy paleve.

12.6. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

12.6.1. Njoftimi i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çënojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5 e 12.1.6 të nenit 12 të kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 12.4 të këtij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar koncesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.


12.6.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Faqe 15 nga 24

Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga koncesionari. Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e fitimit të gares;

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, përqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.

Zëvendësuesi, i cili të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra sigurorese mbi hidrocentralet.

 Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, dhe nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

12.7. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

12.7.1. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të koncesionarit.

Ne rast të zgjidhjes së Kontrates për faj të Koncesionarit, sipas nenit 12.1, Autoriteti Kontraktues i paguan Koncesionarit vetëm shumat e mbetura sipas dokumentave financiare ("Dokumentet Financiare") deri në kufirin e investimit në projekt.

12.7.2. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktues.

Ne rast të zgjidhjes së Kontrates për faj të Autoritetit Kontraktues, ky i fundit duhet të paguaje Koncesionarit, vlerën e investimeve të kryera deri në datën e zgjidhjes së Kontrates si dhe fitimin e munduar të cilin Koncesionari mund ta përfitonte deri në fund të Periudhës së Koncesionit i llogaritur në paragrafin vijues:

Fitimi i munduar = (35 - Numrin e viteve deri në datën e Zgjidhjes) x 0,6 x (Kthimi Mesatar mbi Kapitalin për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes) x (vlera mesatare e Kapitalit të Vet për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes)

12.7.3. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga secila palë

Në rast zgjidhjeje të kontratës nga secila palë, sipas pikës 12.3.1 të këtij neni, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj Koncesionarit.

Page 16 nga 24

Neni 13
Kontratat

- 13.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit, duke respektuar kufizimin e vendosur në nenin 17.2 të kësaj kontrate. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.

Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nën-kontraktuesin e propozuar:

- i. Emrin e tij dhe adresën;
 - ii. Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
 - iii. Vlerën e nënkontratës
 - iv. Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.
- 13.2. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.
- 13.3. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

Neni 14
Sigurimi i kontratës

- 14.1. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 284.871.741 (dyqindetëdhjetë e katër milion e teteqindëshe të dhjetënjemije e shtatëqindëdhjetëzetë), që përbën 7 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.
- 14.2. Koncesionarit i lejohej të ç'ngurtësojë këtë vlerë, bazuar në parashikimet e nenit 11, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kryerja e testimit të veprës dhe vënia në punë.
- 14.3. Sigurimi i Kontrates do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me perfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit.

Neni 15
Sigurimet

- 15.1 Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare dhe përdorimin e Objekteve Ekzistuese (nëse ka), dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet

Faqe 17 nga 24

KONTRATË KONCESIONALE PËR FORAËS "BOT" PËR NËDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHITA", "KLOSI", "DOMI", "LUCI", "SHOSILAJ", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a"

e çertifikuara të çdo çertifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi të arsyeshëm paraprak prej Autoritetit Kontraktues.

- 15.2 Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një muaji, 15 ditë për nga data e sigurimit.
- 15.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruari sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të perdoret për të rinovuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruari do të paguajë për kompesimin e dëmit do të përfitohet nga koncesionari.
- 15.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 15.5 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.
- 15.6 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit. Sigurimi do të mbulojë përgjegjësinë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 16

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

16.1 Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 5 % të prodhimit vjetor të energjisë elektrike.

16.2 Vlera e riinvestimit

Duke filluar nga viti i 25-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate dhe deri në përfundim të Periudhës Koncesionare, Koncesionari do të riinvestojë 60 % të vlerës së investimit për makineri dhe pajisje, sipas një grafiku që do të hartohet nga palët për këtë qëllim. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Faqe 18 nga 24

KONTRATE KONCESIONARE E FORMES "BOT" PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALITVE "GJONI", "BLISHITA", "KLOSI", "DOMI", "LUCI", "SHUSHAJ", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a"

Neni 17 Kufizimet

- 17.1 Koncesionari mund të transferojë aksionet në kapitalin e shoqërisë koncesionare vetëm me miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në rast të transferimit të 100% të aksioneve/kuotave, pasi të jete marrë paraprakisht miratimi si më sipër, Koncesionari përjashtohet nga përgjegjësia e solidarë mbi koncesionin. Shoqëria koncesionare do të jete përgjegjëse në mënyrë solidarë me palën e tretë të ciles do t'i transferohen këto kuota/aksione, në lidhje me këto kontrate koncesioni, për të njëjtin afat të parashikuar në nenin 8. pika 8.1. paragrafi b. të kësaj kontrate.
- 17.2 Koncesionari nuk ka të drejtë të nënkontraktojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, për vlera më të mëdha se 75% të vlerës së investimit, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nën-kontraktore sipas kësaj Kontrate.
- 17.3 Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengun apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontrate.

Neni 18 Raportimi

- 18.1. Koncesionari është i detyruar që çdo tre (3) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19 Legjislacioni i zbatueshem

- 19.1. Lidhja, zbatimimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

Neni 20 Forca Madhore

- 20.1. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:

- i. Katastrofat e natyres, përmbytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to:

Faqe 19 nga 24

KONTRATI KONCESIONI E FORMES "BOT" PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BISHIT C", "KLOSI",
"DOSH", "LUCI", "SHOSIAJ", "ZENISITI", "BURRELI"
Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a"

ii. Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;

20.2. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën. Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për lërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Përbudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 4.2.2 të kësaj kontrate.

20.3. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka te drejte te zgjidhe kontraten e koncesionit :

në rast se edhe pas zbatimit të pikës 20.2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit.

ii. kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj.

20.4. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njera tjetrës dhe secila palë do të përballojë kostot e veta.

20.5. Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 22 të kësaj kontrate.

Neni 21

Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

21.1. Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi me VKM që ka miratuar këtë kontrate, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", i ndryshuar.

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

22.1. Çdo kundërshti mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

22.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata e e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Faqe 20 nga 24

22.3. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Konecioni, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

Neni 23 Sanksionet

23.1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Konecionarin si më poshtë:

i. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0.03 % në javë të vlerës së investimeve të munguara.

ii. Për moskryerje në total të investimeve për vlerën e të cilës është rënë dakord sipas nenit 9.3, deri në 8 muaj, Konecionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të porealizuara.

iii. Për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë.

Këto penalitete do të zbriten nga Sigurimi i Kontratës e parashikuar në nenin 14 më lart, duke pasur parasysh se në qoftë se vlera e sigurimit në fjalë nuk është e mjaftueshme për të paguar një penaltit të tillë, Konecionari do të paguajë shumën e mbetur, rast pas rasti.

23.2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon Konecionarin si më poshtë:

Në rast mosrealizimi, për faj të Konecionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 133.259.000 KWh/vit, Konecionari penalizohet me 5% të prodhimit të porealizuar për periudhën raportuese, duke pasur parasysh se në këtë rast Autoriteti Kontraktues do të marrë të plote tarifën koncesionare prej 5% (për sasi prej 6.662.950 kWh/vit) Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkak të tjera të ligjshme (jo për faj të Konecionarit), Konecionari nuk penalizohet për prodhimin e munguar; nderkaq, Konecionari është i detyruar të paguajë tarifën koncesionare, në vlerën prej 5% të prodhimit të realizuar. Megjithatë palët bien dakord se në rast të mosrealizimit të prodhimit të energjisë prej 133.259 000 KWh/vit, palët mund të ulen të negociojnë midis njera tjetres.

Palët bien dakord që sanksionet e parashikuara në paragrafet 23.2 do të zbatohen deri në një vlerë prej 5 % të vlerës së investimit. Sanksionet do të llogariten çdo fund viti kalendarik, sipas një akti rrekordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrate.

23.3. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 8, pika 2 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Konecionarin me 0.003% të vlerës së investimit për çdo ditë vonese.

Faqe 21 nga 24

- 23.4. Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.
- 23.5. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.
- 23.6. Aplikimi dhe pagimi i penaltiteve sipas këtij neni nuk e çliron koncesionarin nga përmbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.



Neni 24 Rregullimi i shkeljeve

- 24.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjehere ia bën të njohur këtë shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
- 24.2. Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimeve.

Neni 25 Transferimi i Aseteve

- 25.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, burra apo hipoteke.
Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashhtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përhashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 25.2. Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshtim në favor të Autoritetit Kontraktues:
- i. hidrocentralin dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
 - ii. ndërtesa, makineri, pajisje;
 - iii. pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
 - iv. të drejtat kontraktore ;
 - v. dorëzimin e librave, dokumentave dhe garancive që shoqërojnë këto asete;
 - vi. çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;
- 25.3. Koncesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës.

Faqe 22 nga 24

Në rast se kontrata është zgjidhur për shkak të forcës madhore, koncesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e aseteve ku ardhur si pasojë direkte e saj.

25.4. Çdo e drejtë që koncesionari ka fituar me këtë Kontratë, do të mbarojë me transferimin e projektit.

25.5. Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga Koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.

Neni 26 Mbarimi i kontratës

26.1. Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e Neni 4 të kësaj kontrate.

26.2. Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27 Konfidencialiteti

27.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28 Ndryshime

28.1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.

28.2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29 Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.
Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.

Faqe 23 nga 24

KONTRATA KONCESIONARE E I CORNALS "BOY" PËR NDERTIMIN E HIDROCENTRALEVE "GJONI", "BLISHI 1", "KI OSI",
"DOVA", "LI CI", "SHIGSHILJ", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bashkimi i perkohshem i shoqerive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIA Sh.a"

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohej Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.
Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës
Blvd. Zogës-Pare, Nr. 1001,
Tiranë - Shqipëri



Për Koncesionarin

Shoqëria "Riviera",
Adresa:
Tel:
Email:

Neni 30
Rregjistrimi i Kontratës

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, kjo Kontratë duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë
dhe Energjetikës

Përfaqësuar nga :

KONCESIONARI

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive

- (i) "Riviera" shpk
- (ii) "EHW" shpk
- (iii) "Atlantik" shpk
- (iv) "Energy Project" shpk

Përfaqësuar nga :

Shoqëria « Riviera » shpk
Përfaqësues Ligjor

KONTRATE KONCESION, E FORSUES "BOT" PËR NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT "VËLËNI", "BLISHITA", "KLOSI",
"DËMI", "LUCI", "SHOSHAI", "ZENISHTI", "BURRELI"
Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Riviera Sh.p.k.", "EHW Sh.p.k.", "Energy Project Sh.p.k." & "ATLANTIK Sh.a"